



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE

**Zyra e Rregullatorit për Energji**

**Parimet e përcaktimit të ngarkesave në transmision**

2012



Pjesa I – Dispozitat e përgjithshme		3
Neni 1	Hyrje	3
Neni 2	Fushëveprimi dhe qëllimet	3
Neni 3	Përkufizimet dhe interpretimi	3
Pjesa II – Parimet e përbashkëta		5
Neni 4	Mos diskriminimi dhe pasqyrimi i kostos	5
Neni 5	Thjeshtësia dhe transparencë	5
Pjesa III – Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave për transmision		6
Neni 6	Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave për transmision: kërkesat minimale	6
Neni 7	Baza e përcaktimit të ngarkesave	6
Neni 8	Ndarja e ngarkesave për transmision	6
Neni 9	Përcaktimi i ngarkesave për TUOS	7
Neni 10	Oferta e Kushteve për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit	7
Pjesa IV – Kyçja në sistem		9
Neni 11	Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave: kërkesat minimale	9
Neni 12	Kyçja e gjeneratorit	10
Neni 13	Kyçjet e ngarkesave	10
Neni 14	Përcaktimi i taksave për kyçje	11
Neni 15	Oferta e Kushteve për kyçje	11
Pjesa VI - Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare		12
Neni 16	Gjuha zyrtare	12
Neni 17	Ndryshimet	12
Neni 18	Interpretimi	12



## **PJESA I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

#### **Hyrje**

Parimet për Ngarkesat e transmisionit (më tutje “Parimet”) janë të lëshuara nga Rregullatori në përputhje me kompetencat e parapara në Nenin 14 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185, sipas së cilave Bordi i Rregullatorit i aprovon metodologjitë e tarifave të hartuara nga Operatori i sistemit të transmisionit dhe Operatori i tregut për ngarkesat e vëna lidhur me shërbimet e tyre të rregulluara të energjisë.

### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi dhe qëllimet**

- 1 Këto parime i përcaktojnë:
  - a) Parimet mbi të cilat OST dhe OT duhet të hartojnë propozimet e tyre për ngarkesat për shërbime të transmisionit (“metodologjia e përcaktimit të ngarkesave për transmision”), dhe
  - b) Parimet mbi të cilat OST duhet të hartoj propozimet për përcaktimin e taksave për kyçje në Sistemin e transmisionit (“Metodologjia për përcaktimin e ngarkesave për kyçje në transmision”)

të cilat do t’i parashtrohen Rregullatorit për aprovim. Bordi i Rregullatorit pret që Metodologjitë e propozuara të jenë në pajtim me këto parime. Në të kundërtën, Bordi i Rregullatorit do të kërkojë një arsyetim të detajuar për këtë mospërputhje që të vendosë lidhur me aprovimin e këtyre Metodologjive.

- 2 Këto parime duhet të lexohen në përputhje me Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike , Kapitulli III, dhe Rregullin për Vendosjen e Çmimeve të Transmisionit.

### **Neni 3**

#### **Përkufizimet dhe interpretimi**

- 1 Shprehjet në këtë Rregull kanë kuptimet që janë përcaktuar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, në Rregullin për Vendosjen e Çmimeve të OST-së apo në Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike.



- 1.1 “parashtruesi i kërkesës” do të thotë një person fizik apo juridik i cili i kërkon OST-së të bëjë lidhjen e re apo të modifikuar në Sistemin e transmisionit;
- 1.2 “thellë” në raport me lidhjen nënkupton se parashtruesi i kërkesës do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj direkt kostot e aseteve të nevojshme për kyçje në pikën më të afërt të përshtatshme të lidhjes në sistemin ekzistues të transmisionit plus çfarëdo kostosh indirekte që shkaktohen nga punë të ndërlidhura me përforcimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues e të cilat janë shkaktuar si pasojë direkte e krijimit të lidhjes;
- 1.3 “kapaciteti efektiv” do të thotë kapaciteti total në secilin pikë të rrjetit i cili është në dispozicion për t’u shfrytëzuar nga shfrytëzuesit pa i thyer limitet teknike të operimit të rrjetit. Mund të klasifikohet duke iu referuar çfarëdo kriteri teknik përkatës apo standardeve në fuqi duke përfshirë por duke mos u kufizuar në, kapacitetin aktual të bartjes, kapacitetin me qark të shkurtër, limitet e tensionit apo limitet e stabilitetit;
- 1.4 “cekët” në raport me lidhjen nënkupton se parashtruesi i kërkesës do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj vetëm ato kosto direkte që shkaktohen nga krijimi i një lidhjeje të re në pikën më të afërt të përshtatshme të sistemit ekzistues të transmisionit
- 1.5 “Shfrytëzuesi” ka kuptim siç është e përcaktuar me Kodin e rrjetit.



## **PJESA II – PARIMET E PËRBASHKËTA**

### **Neni 4**

#### **Mos diskriminimi dhe pasqyrimi i kostos**

1 Në hartimin e Metodologjisë së përcaktimit të taksave të paraparë në Nenin 2 më lartë, OST duhet të ngarkojë ose ofroj të ngarkojë me çmim cilindo person për ndonjë kyçje apo shfrytëzim të sistemit, i cili:

- a) nuk dallon materialisht nga ato të cilat ngarkohen apo i ofrohen ndonjë personi tjetër i cili parashtron kërkesë për një shërbim të ngjashëm; dhe
- b) Pasqyron, në masë të arsyeshme, kontributin që jep personi i tillë për kostot e përgjithshme të ofrimit të shërbimit të kërkuar.

2 Teksa shqyrton nëse do të aprovojë Metodologjinë e përcaktimit të ngarkesave për OST, Rregullatori i konsideron si ngarkesa që reflektojnë koston ato ngarkesa të cilat janë përcaktuar të rikthejnë kostot nga cilado klasë e shfrytëzuesve kostot totale, përfshirë edhe kostot e investimeve, të cilat OST i ka dëshmuar se mund t'i atribuohen asaj klase.

### **Neni 5**

#### **Thjeshtësia dhe transparencja**

1 Ngarkesat duhet të jenë sa më të thjeshta, transparente dhe të parashikueshme që të jetë e mundur, e njëherit të pasqyrojnë nevojën për të optimizuar shfrytëzimin e rrjetit dhe të reflektojnë kostot e shkaktuara në emër të sistemit dhe për shfrytëzues të caktuar dhe duhet të shmang rrezikun sa më shumë të jetë e mundur për vendimet e shtrembëruara për investim.

2 Ngarkesat duhet të marrin parasysh zhvillimet e ardhshme në strukturën e sektorit të energjisë elektrike dhe të lejojnë rregullim më të sofistikuar krahas zhvillimit të tregut.



## PJESA III – METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË NGARKESAVE PËR TRANSMISION

### Neni 6

#### Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Transmision: kërkesat minimale

- 1 Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave duhet t'iu mundësojë shfrytëzuesve të sistemit që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi ngarkesat në fuqi për shërbimet e sistemit të transmisionit, operatorit të sistemit dhe të operatorit të tregut dhe duhet të përfshin sipas nevojës,
  - a) Bazën mbi të cilën do të llogariten ngarkesat për klasat e ndryshme të shfrytëzuesve, klasat e tarifave apo klasat e tensionit për çdo lloj të shërbimit;
  - b) Bazën mbi të cilën do të caktohen ngarkesat e veçanta për kapacitetin në qarqet e sistemit të transmisionit;
  - c) Listën e çfarëdo ngarkesave që mund të kërkohen për ofrimin dhe instalimin e çdo njehsori, përfshirë njehsorët kontrollues, apo ndonjë impianti elektrik në pikat hyrëse apo dalëse, të cilat ndihmojnë dhe janë të domosdoshme për lejimin e shfrytëzimit të sistemit dhe për mirëmbajtjen e njehsorëve apo impianteve të tilla;
  - d) Kriteret mbi të cilat merret vendimi i OST-së për të refuzuar qasje në sistem, kritere këto që duhet të jenë objektive, dhe teknikisht e ekonomikisht të arsyetuara.

### Neni 7

#### Baza e përcaktimit të ngarkesave

- 1 Në përcaktimin e bazës së duhur për përcaktimin e ngarkesave për shfrytëzuesit për përdorimin e sistemit në kuptim të Nenit 6.1 a), OST duhet të merr parasysh kostot afatgjata të mirëmbajtjes së një sistemi të sigurt, të siguruar dhe të besueshëm në mënyrë që të përmirësohet parashikueshmëria, stabiliteti dhe pasqyrimi i kostos së çmimeve në aspektin afatgjatë.
- 2 Në hartimin e Metodologjisë për përcaktimin e ngarkesave për shfrytëzim të sistemit, OST-ja duhet të merr parasysh kostot afatgjate, margjinale, kostot e shmangura të rrjetit që shkaktohen nga masat për menaxhimin e anës së kërkesës.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Pakoja e dytë, preambula, paragrafi 18



## Neni 8

### Ndarja e ngarkesave për transmision

- 1 OST duhet ti mbulojë ngarkesat e TUOS përmes një koeficienti prej 0% ndaj gjenerimit dhe 100% ndaj ngarkesës.
- 2 OST duhet ti mbulojë ngarkesat për shërbimet e operatorit të tregut dhe operatorit të sistemit përmes një koeficient prej 50% ndaj gjenerimit dhe 50% ndaj kërkesës.
- 3 Ngarkesat duhet të përcaktohen në mënyrën e cila mundëson diferencimin e kostos për ofrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmisionit, të disponueshëm në nivele të ndryshme të tensionit.

## Neni 9

### Përcaktimi i ngarkesave për TUOS

- 1 Deri në përmasat në të cilat kostoja e tillë mund t'i ngarkohet shfrytëzuesit (ose në rast të ngarkesave mesatare, një klase të shfrytëzuesve), ngarkesat për shfrytëzim të sistemit mund të përcaktohen për t'i rikthyer:
  - a) Kostot kapitale dhe të punës për mirëmbajtjen e një sistemi të sigurt, të siguruar dhe të besueshëm, në përputhje me standardet kombëtare në fuqi<sup>2</sup> që vlejné për transportin e energjisë elektrike nga pika hyrëse e shfrytëzuesit deri të pika dalëse, dhe atë deri në masën ku këto kosto nuk mund të rikthehen nga ndonjë ngarkesë tjetër;
  - b) Kostoja e mirëmbajtjes së tensionit dhe frekuencës në kuadër të kufijve kombëtar në fuqi siç është detajuar në Kodin e rregullimit;
  - c) Kostoja e humbjes në transmision në formën e furnizimeve shtesë të nevojshme për t'i mbuluar këto humbje në transmision;
  - d) Kostoja e ofrimit, instalimit dhe mirëmbajtjes së matjeve relevante, deri në masën ku këto kosto nuk mund të rikthehen nga ndonjë ngarkesë tjetër; dhe
  - e) Çfarëdo kosto tjetër të cilën, kohë pas kohe, Rregullatori mund ta aprovojë si të rikthyeshme përmes sistemit të ngarkesave ashtu siç përcaktohet në Rregullin e Çmimit të OST-së.
- 2 Nga shfrytëzuesit nuk duhet të pritët që të paguajnë për kostot kapitale, operative apo të mirëmbajtjes në lidhje me asetet në nivele të tensionit të cilat nuk i shfrytëzojnë. Për shembull, kjo nënkupton që shfrytëzuesve të kyçur në sistem në tension më të lartë të Transmisionit nuk do t'u kërkohej që të paguajnë për ofrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të tensionit që është më i ulët sesa

---

<sup>2</sup> Terminologjia që përdoret në vend të "të aprovuar nga ZRRE" për të lejuar transponim të menjëhershëm të standardit që parashtrahet nga EnCT ose, në rast të transmisionit, ENTSO-E



tensioni i kyçjes së tyre. Për t'iu shmangur dyshimit, asetet e rrjetit në këtë kontekst nuk i përfshijnë asetet të cilat i nënshtrohen marrëveshjes për kyçje.

## **Neni 10**

### **Oferta e Kushteve për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit**

- 1 Në kërkesën e parashtruar nga ndonjë person, OST duhet të ofrojë të lidh marrëveshje për ofrimin e shfrytëzimit të shërbimeve të sistemit.
- 2 Oferta në paragrafin 1 duhet të bëhet jo më vonë se [28] ditë pas pranimit të kërkesës.
- 3 Oferta për të vënë në dispozicion shfrytëzimin e shërbimeve të sistemit duhet t'i përcaktoj pikat e hyrjes në sistem, pikat e daljes nga sistemi dhe sasinë që kërkohet të transportohet, si dhe të gjitha shërbimet tjera të cilat mund të kërkohen me kërkesë, dhe duhet t'i përcaktoj çmimet që duhet të paguhet për shërbimet e tilla.
- 4 Çfarëdo marrëveshje, apo ofertë e bërë nga OST-ja duhet të jetë në pajtim me Ligjet e Kosovës, Kodin e rrjetit, licencën apo ndonjë rregull tjetër të lëshuar nga Rregullatori.





## PJESA IV – KYÇJA NË SISTEM

### Neni 11

#### Metodologjia e përcaktimit të taksave: kërkesat minimale

- 1 Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave duhet të përpilohet në mënyrë të tillë me të cilën do t'u mundësohet shfrytëzuesve të sistemit që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi taksat e kyçjes në fuqi.
- 2 Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave duhet të përfshijë,
  - a) listën ku janë cekur këto pika (përfshirë kryerjen e punëve, dhe ofrimin dhe instalimin e linjave elektrike, impianteve apo njehsorëve) të kostove domethënëse, të cilat mund të kërkohen për qëllime të kyçjes (në pikat hyrëse dhe dalje) të sistemit të transmisionit për të cilat mund të paguhen taksat për kyçje dhe, sipas mundësisë, përfshijnë taksa indikative kundrejt çdo pike të cekur në listë ose (nëse kjo nuk është e mundur) bazën mbi të cilën këto ngarkesa do të llogariten;
  - b) bazën mbi të cilën do të llogariten ngarkesat kundrejt zgjerimit apo përforcimit të sistemit të transmisionit të cilën OST-ja beson, në mënyrë të arsyeshme, se janë të domosdoshme për t'i ofruar një kyçje parashtruesit të kërkesës pa rrezikuar stabilitetin apo sigurinë e sistemit;
  - c) bazën mbi të cilën do të llogariten ngarkesat ku sigurimi i linjave elektrike apo impiantit që duhet të instalohet janë të kapacitetit më të madh sesa që nevojitet për nevoja të parashtruesit të kërkesës;
  - d) bazën mbi të cilën do të llogariten ngarkesat për mirëmbajtje dhe riparim të linjave të energjisë elektrike, impiantit apo njehsorëve të instaluar për qëllime të sigurimit të lidhjes;
  - e) bazën mbi të cilën do të llogariten taksat në raport me de-energizimin e kyçjes së konsumatorit, çkyçjen nga sistemi i OST-së për transmision dhe largimin e linjave elektrike, impiantit dhe njehsorëve pas çkyçjes.
- 3 Për t'iu shmangur dyshimit, në rastet kur asetet janë paguar nga kontributet e konsumatorit për koston e kyçjes, vlera e atyre asetëve do t'i shtohet bazës së asetit të rregullatorit të të licencuarit por se shumica e kontributit të konsumatorit do të zbritet nga të hyrat e lejuara të të licencuarit.
- 4 Metodologjia duhet të përfshijë një listë të të gjitha informatave të cilat kërkohen nga parashtruesi i kërkesës që kërkon kyçje në Sistemin e transmisionit, përfshirë edhe formularët mostra të cilat parashtruesi i kërkesës duhet t'i plotësojë. Në rast të kyçjeve komplekse, OST mund të kërkojë informata shtesë nga parashtruesi i kërkesës.



5 Metodologjia e aprovuar duhet të botohet, para hyrjes në fuqi, në ueb faqen e OST-së dhe do të lejohet shkarkimi i saj nga parashtrues të mundshëm të kërkesave, ndërsa kopjet fizike duhet t'iu vihen në dispozicion pa pagesë cilitdo parashtrues të kërkesave të cilët nuk kanë qasje në media elektronike.

## **Neni 12**

### **Kyçja e gjeneratorit**

Parashtruesit e kërkesës për kyçje të gjenerimit të ri, rritjes së kapacitetit të kyçjes për gjenerimin ekzistues, duhet të paguajnë taksa të thella të kyçjes, të përcaktuara ashtu që të mundësojnë rikthimin e kostove direkte për sigurimin e kyçjes në pikën më të afërt të përshtatshme në sistemin e transmisionit, përfshirë edhe matjet dhe transformatorët për ngritje të një niveli, të domosdoshme për të mundësuar lidhjen, së bashku me koston e përforcimit dhe të rikonfigurimit të sistemit e cila mund të rezultojë nga ndonjë kyçje në ndonjë pikë më lartë se vetë pika për kyçje.

## **Neni 13**

### **Kyçjet e ngarkesës**

3 Ngarkesat e OST-së për kyçje duhet të përcaktohen në bazë të:

a) rikthimin e kostos për kyçje të thellë, ku:

- i. një ngarkesë e re apo rritja në ngarkesë tejkalon 3% të kapacitetit ekzistues efektiv në pikën e kyçjes në rrjetin e transmisionit, dhe
- ii. kyçja nuk është paraparë në Planin zhvillimor të transmisionit, dhe
- iii. kostot indirekte të punëve që lidhen me përforcimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues dhe të cilat janë shkaktuar si pasojë direkte e krijimit të lidhjes e cila tejkalon për dhjetë herë të hyrat e pritura të TUOS nga ngarkesa përkatëse për kyçje, ose

b) rikthimi i kostos për kyçje të cekët, ku:

- i. një ngarkesë e re apo rritja në ngarkesë nuk tejkalon 3% të kapacitetit ekzistues efektiv në pikën e kyçjes në rrjetin e transmisionit, ose
- ii. kyçja parashihet në Planin zhvillimor të transmisionit, ose



- iii. kostot indirekte të punëve që lidhen me përforcimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues dhe të cilat janë shkaktuar si pasojë direkte e krijimit të lidhjes e cila nuk tejkalon për dhjetë herë të hyrat e pritura të TUOS nga ngarkesa përkatëse për kyçje.

#### **Neni 14**

##### **Përcaktimi i taksave për kyçje**

- 1 OST parashtron Metodologjinë e vet për përcaktimin e taksave për kyçje për aprovim të Rregullatorit në përputhje me Kapitullin V të Rregullit të Përcaktimit të Çmimit dhe me këto Parime të përcaktimit të ngarkesës.
- 2 Ngarkesat nuk hyjnë në fuqi para se të aprohohen nga Rregullatori. Rregullatori do t'i aprovoj ngarkesat apo do të ofroj arsye për mos aprovimin e tyre brenda 60 ditëve nga data e dërgimit të ngarkesave të tilla te Rregullatori.

#### **Neni 15**

##### **Oferta e Kushteve për kyçje**

- 1 Në rastet kur OST ka pranuar kërkesë formale për kyçje me të gjitha informatat e nevojshme sipas Metodologjisë së aprovuar për përcaktim të ngarkesave, ai duhet të jep ofertë formale për të kyçur parashtruesin e kërkesës brenda afateve kohore të parapara me Nenin 9.7 të Kushteve të përgjithshme të furnizimit me energji elektrike.
- 2 Oferta formale duhet të përmbajë datën deri kur do të përfundojnë punët e kyçjes.
- 3 Në rastet kur OST-ja dhe parashtruesi i kërkesës pajtohen, oferta formale mund të përmbajë kushtet për pagesat e interesit për moskryerjen, nga cilado anë, e punëve të domosdoshme apo të ofrojnë pëlqime të domosdoshme e të cilat çojnë në vonesa dhe kosto për palën tjetër.
- 4 Çfarëdo marrëveshje, apo ofertë e bërë nga OST-ja duhet të jetë në pajtim me Ligjet e Kosovës, Kodin e transmisionit, licencën e tij apo ndonjë Rregull tjetër të lëshuar nga Rregullatori.



## **PJESA V - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 16**

#### **Gjuha zyrtare**

Këto parime janë nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehen në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes mes versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

### **Neni 17**

#### **Ndryshimet**

ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të këtyre Parimeve pas procesit të rishikimit të konsultimit publik.

### **Neni 18**

#### **Interpretimi**

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e këtyre Parimeve, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar